



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI  
KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË  
DREJTAT E NJERIUT**

**NËNKOMISIONI PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

**RAPORT**

**MBI PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES SË ANËTARIT TË SHQIPËRISË PRANË  
KOMITETIT EVROPIAN PËR PARANDALIMIN E TORTURËS DHE TRAJTIMIT  
OSE NDËSHKIMIT ÇNJERËZOR OSE DEGRADUES (CPT).**

**HYRJE**

Sekretari i Përgjithshëm i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, z. Wojciech Sawicki, përmes një letre drejtuar Kryetarit të Delegacionit të Kuvendit të Shqipërisë pranë kësaj Asambleje, z. Ervin Bushati, njoftoi për fillimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarit të Shqipërisë pranë Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (CPT).

CPT është një organ i specializuar i Këshillit të Evropës për monitorimin e institucioneve të privimit të lirisë. Ai përbëhet nga ekspertë të pavarur dhe të paanshëm siç janë: avokatët, mjekët dhe ekspertët në çështje të burgjeve ose të policisë.

Çdo shtet anëtar i Këshillit të Evropës ka një përfaqësues në këtë organ monitorues me mandat 4-vjeçar (me të drejtë ri-zgjedhjeje). CPT realizon vizita monitoruese në shtetet anëtare me qëllim monitorimin e trajtimit e personave të privuar nga liria në institucione si: stacionet e policisë, burgjet, qendrat e paraburgimit për të mitur, qendrat e ndalimit të imigracionit, spitalet psikiatrike ose shtëpitë e kujdesit social. Pas vizitave monitoruese përgatiten dhe raportet me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.

Aktualisht, anëtare e Shqipërisë pranë këtij organi është znj. Arta Mandro, mandati i së cilës përfundon në Dhjetor 2019.

Sipas procedurës, Kuvendi duhet të paraqesë një listë me tre kandidatë që plotësojnë kriteret sipas standarteve të CPT-së. Letra me tri kandidaturat e propozuara, përveç tri CV-ve të detajuara sipas modelit të sekretariatit, duhet të përshkruajë edhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve. Lista me tre kandidatw duhet detyrimisht të përfshijë përfaqësues të të dy gjinive (së paku nga një kandidat për secilën gjini).

Rezoluta nr. 1540 (2007) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës “Për përmirësimin e procedurave për anëtarët e CPT” dhe nr. 2160 (2017) fton vendet anëtare të përmirësojnë

procedurat e përzgjedhjes, në mënyrë që të sigurohet transparenca e tyre dhe forcimi i mekanizmave për të siguruar përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë përmes:

- thirrjes publike për paraqitje interesi/kandidatura të hapura për meshkuj dhe femra;
- këshillimin për kandidatët e përshtatshëm me organet përkatëse qeveritare ose jo qeveritare (p.sh. ministrinë e Drejtësisë, Shëndetësisë dhe atë të Brendshme, administratës së burgjeve, insitucioneve akademike, OJQ aktive në luftën kundër torturës dhe në ndihmë të të burgosurve);
- zhvillimin e intervistave me kandidatët që kalojnë fazën e parë për të vlerësuar kualifikimet e tyre, motivimin dhe disponibilitetin si dhe aftësitë në gjuhën angleze ose franceze, mundësisht nga një panel i pavarur ekspertësh;
- përfshirjen aktive në fazat finale të procesit para-seleksionues të delegacionit pranë APKiE;
- përdorimi nga aplikantët i modelit të CV standart të përcjellë nga sekretariati (bashkëlidhur)

Sipas Rezolutave 1248 (2001), 1540 (2007) dhe 2160 (2017) lista e kandidatëve e përcjellë nga Kuvendi, do të vlerësohet nga Nën-Komisioni për të Drejtat e Njeriut pranë Komisionit të Çështjeve Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut të APKiE, i cili do i përcjelli një rekomandim Byrosë së Asamblesë duke listuar kandidatët sipas rendit të preferencës (bazuar në vlerësimin e tyre). Lista e miratuar nga Byroja e Asamblesë votohet nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës.

## **PROCEDURA E NDJEKUR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË**

Kuvendi i Shqipërisë në datën 13.03.2019 shpalli në faqen zyrtare të tij<sup>1</sup> hapjen e fazës së parë të aplikimit, thirrjen për paraqitje të interesit nga kandidatët/et, duke ftuar çdo person që përmbush kriteret e mëposhtme:

- ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në një nga fushat si: drejtësi, mjekësi, psikologji, shkencat sociale, me diplomë “Master i Shkencave” ose studimet universitare jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të barazvlefshme, e njesuar sipas rregullave për njësimin e diplomave parashikuar nga legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë;
- ka integritet moral dhe profesional, përvojë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;
- ka të paktën 10 vjet përvojë profesionale aktive në një nga fushat e mësipërme;
- nuk është i dënuar me vendim penal të forms së prerë;
- zotëron shumë mirë, me shkrim dhe me gojë një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës (anglisht ose frëngjisht);

Krahas kërkesës për shprehje interesi, kandidati/ja duhet të paraqesnin në zyrën e protokollit të Kuvendit, ose me postë dokumentacionin e mëposhtëm duke përcaktuar afatin e dorëzimit brenda datës 28.03.2019:

1. CV e përditësuar në gjuhën angleze ose franceze sipas modelit standart të përcjellë nga sekretariati i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës që i është bashkëlidhur njoftimit;

---

<sup>1</sup> <http://www.parlament.al/News/Index/7245>

2. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave së arsimit të lartë dhe të studimeve pasuniversitare, të titujve ose gradave shkencore;
3. Kopje e noterizuar e librezës së punës që vërteton përvojën në një nga fushat e kërkuara;
4. Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
5. Formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Formulari i vetëdeklarimit gjendet bashkëlidhur këtij njoftimi;
6. Dy rekomandime nga përfaqësues të institucioneve të pavaruara ose organizata të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut.

Në përfundim të fazës së parë të procedurës për zgjedhjen e anëtarit të Shqipërisë pranë CPT, në datën 01.04.2019, Kuvendi publikoi në faqen e tij zyrtare<sup>2</sup> emrat e kandidatëve që iu përgjigjën thirrjes për shprehje interesi si më poshtë:

1. Znj. Arta Mandro
2. Z. Aurel Borici
3. Znj. Brunilda Menella
4. Znj. Drita Avdyli
5. Znj. Erinda Bllaca Ndroqi
6. Znj. Helena Papa
7. Znj. Luljeta Ikonimi Caraoshi

Në datën 04.04.2019 Kuvendi njoftoi në faqen e tij zyrtare<sup>3</sup> se Nënkomisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me Delegacionin e Përhershëm të Kuvendit pranë Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës do të vijonte procedurën e përzgjedhjes paraprake të kandidaturave. Seanca dëgjimore me kandidatët për të vlerësuar kualifikimin e tyre, motivimin, disponibilitetin dhe njohuritë e gjuhës angleze ose franceze u caktua të zhvillohej ditën e premte datë 12.04.2019, ora 10:30.

Në kuadër të transparencës dhe forcimit të mekanizmave për të siguruar përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë, u ftuan të marrin pjesë në seancë dëgjimore institucione dhe organizata që në fushën e veprimtarisë së tyre kanë mbrojtjen e të drejtave të njeriut e veçanërisht ato që në fokus të veprimtarisë së tyre kanë parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria si: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Prezenca e OSBE, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Shoqata “Përthyerje”, Shoqata Avokatët Penalistë, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës, Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Qendra Europiane, Sherbimi Ligjor Falas, Qendra Res Publica, CRCA, Qendra Shqiptare e të Drejtave të Njeriut, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Qendra e Aleances Gjimore për Zhvillim, Shoqata për Grate dhe Femijet, Partnere për femije, UNICEF Albania, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – Soros, Koalicioni "Drejtësi për të gjithë", Fakulteti i Drejtësisë.

<sup>2</sup> <http://www.parlament.al/News/Index/7281>

<sup>3</sup> <http://www.parlament.al/News/Index/7297>

Të gjithë subjekteve të lartpërmendur, që iu kërkua të marrin pjesë në rolin e vëzhguesit, iu drejtua ftesa që pas fazës së intervistave të rekomandojnë aplikantët që atyre iu duken më të përshtatshëm për t'u përzgjedhur si kandidatë për anëtarë të CPT, duke i përcjellë sugjerimet e tyre me shkrim në adresën e nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut.

Gjithashtu, për një vlerësim sa më profesional të njohurive të gjuhës angleze dhe/ose franceze të kandidatëve, u çmua e rëndësishme pjesëmarrja në këtë seancë e pedagogëve të Departamentit të Gjuhës Angleze dhe Departamentit të Gjuhës Frënge nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja pranë Universitetit të Tiranës.

Kuvendi i Shqipërisë me shkresën nr. 1473/1 prot. datë 05.04.2019 iu drejtua Dekanit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës me kërkesë për caktimin e pedagogëve të këtij departamenti për të marrë pjesë në seancat dëgjimore me kandidatët për një vlerësim sa më profesional të njohurive të tyre.

Në përgjigje të shkresës së Kuvendit të Shqipërisë, Dekani i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, me shkresën nr. 785/1 prot., datë 09.04.2019 i përcolli Kuvendit listën me emrat e pedagogëve që do të marrin pjesë në seancat dëgjimore.

Përpara realizimit të seancave dëgjimore, grupi i këshilltarëve ligjorë të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, i përbërë nga znj. Lindita Rusmali, znj. Edlira Rama dhe z. Ilir Bajraba shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët dhe vlerësoi përmbushjen e kritereve formale nga ana e tyre. Këshilltarët ligjorë të Komisionit hartuan një relacion që i bashkëngjitet këtij raporti. Nga verifikimi i kritereve formale juridike rezultoi se të gjithë aplikantët përmbushin kriteret që përcaktoheshin në thirrjen për shprehje interesi.

Thirrjes për kandidim iu përgjigjën 7 (shtatë) kandidatë. Në mbledhjen e datës 12 prill 2019, Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut dëgjoi në intervistë vetëm 5 (pesë) kandidatë. Njëra prej kandidatëve, znj. Luljeta Ikonimi Caraoshi u tërhoq përpara zhvillimit të intervistës, duke paraqitur dorëheqjen me shkrim të dërguar në adresën e Komisionit për Çështjet Ligjore në datën 12.04.2019.

Me kërkesë të vetë kandidates, intervista me znj. Helena Papa u shty për në mbledhjen e datës 15 prill 2019, për arsye objektive të paraqitura nga aplikantja, e cila nuk mund të ishte e pranishme në intervistën e datës 12 prill 2019.<sup>4</sup>

Anëtarët e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, anëtarët e Delegacionit të Kuvendit të Shqipërisë pranë Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës si dhe të pranishmit e ftuar në seancë dëgjimore u njohën me kërkesën, arsyet e shtyrjes dhe ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore. Data e zhvillimit të seancës u caktua ditën e hënë, datë 15.04.2019, ora 12:00.

Mbledhjet e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, përfshirë procesin e intervistimit të kandidatëve, janë të rregjistruara dhe procesverbalet e zbardhura publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, pas miratimit të tyre në mbledhjen e rradhës së Nënkomisionit. Anëtarët e Delegacionit të Kuvendit në APKiE morën pjesë aktive në procesin e intervistimit dhe ishin të pranishëm në çdo mbledhje të Nënkomisionit.

---

<sup>4</sup> Procesverbali i mbledhjes së nënkomisionit datë 12.04.2019

Mbledhjet e Nënkomisionit u drejtuan nga deputeti më i vjetër z. Xhemal Qefalia, për shkak të dorëheqjes nga procesi i kryetares së Nënkomisionit, znj. Vasilika Hysi, për arsye të konfliktit të interesit në dukje, deklaruar në formularin e deklarimit të gjendjes së konfliktit të interesit nga znj Hysi, publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit.<sup>5</sup>

Në datën 25.04.2019, Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut kreu vlerësimin për secilin kandidat/e duke u bazuar në:

- raportin e grupit të këshilltarëve ligjorë të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura;
- intervistat me secilin kandidat/e;
- relacionin e profesorëve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për vlerësimin e njohurive të kandidatëve.

Nënkomisioni mbajti parasysh edhe mendimin/rekomandimin e subjekteve vëzhguese si dhe opinionin e anëtarëve të Delegacionit të Kuvendit në APKiE. Rekomandime për aplikantët kanë dhënë: zëvendësministrja dhe përfaqësuesja e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Bardhylka Kospiri, Organizata “Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare”.

Në përfundim të procesit të vlerësimit, në mbledhjen e datës 25.04.2019, Nënkomisioni vendosi të rekomandojë listën me tre kandidatë për anëtarë të CPT, caktuar nga Shqipëria (sipas rendit alfabetik), si vijon:

- 1. Arta Mandro**
- 2. Aurel Borici**
- 3. Helena Papa**

Një përmbledhje e shkurtër për kualifikimet e kandidatëve të përzgjedhur:

- 1. Znj. Arta Mandro** është diplomuar për drejtësi në Universitetin e Tiranës (1982-1986). Në vitin 1994 merr gradën shkencore “Doktor”. Ka fituar titullin shkencor “Profesor i Asociuar”(1999) si edhe “Profesor”(2009). Znj. Mandro është anëtare e CPT (2015-2019) dhe ka përvojë pune si jurist mbi 30 vjet, e angazhuar si pedagoge në Shkollën e Magjistraturës (2002 dhe aktualisht), pedagoge dhe shefe e Departamentit të së Drejtës Publike në Fakultetin e Drejtësisë, UT (1986 -1998). Ka shërbyer edhe si Zëvendësministre e Drejtësisë (1998-2000), eksperte, konsulente pranë UNICEF Albania, UNDP Albania, UN Women, USAID, Prezencës së OSBE në Tiranë; drejtuese dhe koordinatorë e disa projekteve në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut; anëtare e disa organizatave të shoqërisë civile.
- 2. Z. Aurel Borici** është diplomuar në Fakultetin e Gjuhës Angleze, Universiteti i Tiranës (2002-2006) dhe ka kryer studimet master të nivelit të dytë në politikë të jashtme dhe diplomaci, Universiteti “UFO”. Ka eksperience pune pranë medias si gazetar dhe aktualisht është i angazhuar në rolin e drejtuesit të sektorit të Marrëdhënieve me Publikun në Bashkinë e Tiranës.
- 3. Znj. Helena Papa**, është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (1997-2001). Ka kryer studimet BA dhe Master i Nivelit të Dytë “ E drejtë Ekonomike - Menaxhim” në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Besancon, Francë. Ka përvojë pune

<sup>5</sup> <https://www.parlament.al/Files/RaporteStatistika/DeklarataV.Hysi.pdf>

si koordinatorë për zbatimin e Strategjisë Antikorrupsion pranë KM, drejtor kabinetit në ILDKPI dhe KLGJ, drejtuese projektesh për Ambasadën Britanike në Tiranë dhe Këshillin e Evropës, eksperte ndërkombëtare në fushën e antikorrupsionit, çështjeve të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut.

Bashkangjitur CV- të për secilin kandidat sipas formës së kërkuar në aplikim.

Lista me tre kandidatët e përzgjedhur do t'i përcillet nga ana e Delegacionit Shqiptar në APKiE Sekretariatit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për të vijuar me fazat e tjera dhe përzgjedhjen e përfaqësuesit për Shqipërisë pranë CPT.

Ky raport të botohet në faqen zyrtare të Kuvendit dhe t'u shpërndahet për njohje të gjithë deputetëve të Kuvendit.

**VASILIKA HYSI**

**KRYETARE**